

Përmbajtja

Faqe 2

OJQ-të bëjnë thirrje për reformë pensioniste

Kosova në mesin e vendeve më optimiste në botë, përsëri

Ndërroi jetë humanistja Feride Dërvishi

Faqe 3

Dhuna ndaj gazetareve në ngritje

OJQ-të e grave RAE formalizojnë rjetin e tyre

Lëvizja e lirë e mallrave dhe njerëzve në Kosovë dhe Serbi

Faqe 4

Drejt krijimit të një ambienti të përshtatshëm juridik për shoqërinë civile


Zhvillimi i shoqërisë civile në Shqipëri

Mundësi të reja të financimit, lajme, ngjarje, trajnime etj. mund të gjenden në Web faqen e ATRC-së: <http://www.advocacy-center.org>



Shoqëria civile kosovare shpreh ngushëllime për vdekjen e kryetarit Rugova

Përfaqësues të shoqërisë civile kanë shprehur ngushëllimet e tyre në një letër dërguar familjes së Kryetarit Dr. Ibrahim Rugova, Presidencës dhe popullit të Kosovës.



Shoqëria civile e bashkuar sot në dhembjen e madhe me rastin e vdekjes së Kryetarit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova shpreh ngushëllimet e veta familjes Rugova, Presidencës dhe mbarë popullit në Kosovë.

Presidenti shkoi në kohën më të rëndësishme kur po vihen themelet e një Kosove të pavarur; dëshirë kjo që të gjithë së bashku e presim me padurim të ndodh me njohjen formale të një Kosove sovranë dhe të dashur për të gjithë.

Rruga e shoqërisë civile për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të një Kosove të pavarur e sovranë ishte e njëjtë dhe e përbashkët qysh nga fillimi i viteve '90'.

Ashtu si jemi të bashkuar ne sot shoqëria civile, kërkojmë nga të gjithë faktorët politik të jenë të bashkuar dhe me një pjekuri politike e të qëndrueshme ta realizojnë së bashku amanetin e vizionarit dhe misionarit që tërë jetën ia kushtoi ndërtimit të shtetit të pavarur demokratik e sovran të Kosovës.

Rrjeti i Grave të Kosovës
Lobi i Grave të Kosovës
Fondacioni për Iniciativë Demokratike
Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Partneret Kosova, Qendra për Administrim të Konfliktëve

Kryetari Dr. Ibrahim Rugova (1944 - 2006)

Ibrahim Rugova u lind më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cerrcë, komuna e Istogut. Ai diplomoi në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës dhe një vit e kaloi në Paris në Ecole Pratique des Hautes Etudes. Doktoratën në letërsisë e mori në Universitetin e Prishtinës më 1984. Dr. Rugova u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës më 1988, gjë që u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes opozitare shqiptare ndaj pushtetit serb në Kosovë. Më 23 dhjetor 1989, ai u zgjodh kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Pas zgjedhjeve parlamentare më 24 maj 1992, të cilat nuk ishin të njohura ndërkombëtarisht, Rugova u zgjodh kryetar i Republikës së Kosovës. Nën udhëheqjen e tij, shqiptarët e Kosovës ndërtuan struktura paralele administrative, shëndetësore dhe arsimore në kuadër të rezistencës paqësore.

Pas luftës, Dr. Rugova u zgjodh kryetar në mars të 2002-ës dhe përsëri u rizgjodh në këtë post më 2005. Si kryetar, ai avokoi për njohje ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Pas një beteje kundër kancerit në mushkri, ai vdiq në moshën 61 vjeçare, më 21 janar 2006. Ai është shpërblyer me një sërë çmimesh ndërkombëtare, përfshirë Çmimin Sakharov të Parlamentit Evropian, Çmimin Senator Nderi i Evropës, Çmimin për Paqe të Fondacionit Paul Litzer dhe është shpallur Doktor Nderi i Universitetit të Parisit VIII Sorbone.

Tryezë e rrumbullakët e ATRC-së dhe KODI-t

OJQ-të bëjnë thirrje për reformë pensioniste

ATRC dhe Instituti Kosovar për Kërkime dhe Dokumentim (KODI) kanë organizuar tryezë të rrumbullakët më 14 dhjetor në ATRC, ku autoritete dhe përfitues të sistemit pensioniste u mblodhën për të adresuar çështje që kanë të bëjnë me kualitetin e shërbimeve pensioniste në Kosovë. Pensionistë dhe përfaqësues të OJQ-ve, qeverisë dhe mediave ishin pjesëmarrës në tryezën e

moderuar nga Kushtrim Shaipi nga KODI. Panelistë ishin Naim Hoda - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Abedin Kajtazi - BPK, Ramis Ahmetaj - Trusti i Kurtimeve Pensionale, Shaban Kajtazi - Shoqata e Pensionistëve të Kosovës dhe Fazli Kajtazi - Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës.

Shaban Kajtazi nga Shoqata

e Pensionistëve komentoi se UNMIK-u dhe autoritetet lokale vazhdojnë t'i shkelin të drejtat e pensionistëve. Ai konstatoj se pagesa mujore €40 për qytetarët e Kosovës mbi moshën 65 vjeçare, pa marrë parasysh përvojën e punës, është diskriminuese. "€40 nuk është pension, kjo është vetëm përkrahje sociale", ka thënë ai.

(Vazhdon në faqen 2)

Flash Lajme

**Ndërroi jetë
humanistja Feride
Dërvishi**



Feride Dërvishi, humaniste dhe aktiviste e shumë organizatave humanitare vendore dhe ndërkombëtare, ka vdekur më 7 janar në Nashville, Tennessee, SHBA. Dërvishi u lind më 1967 në fshatin Gradicë të Drenicës.

Me gjithë betejën personale për ta mposhtur polion, ajo u përkushtua për t'i ndihmuar të tjerëve - mentalisht, shpirtërisht dhe fizikisht. Ajo u përqendrua posaçërisht në ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet personave me aftësi të kufizuara dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Gjatë viteve të 90-ta ajo bashkëpunoi me shumë organizata humanitare vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë UNICEF-in, Save the Children, Fondacionin SOROS, Motrat Qiriaz (Kosovë), OXFAM-in dhe Catholic Charities (SHBA).

Që nga viti 1999, ajo jetoi dhe punoi në Nashville, Tennessee ku i përfundoi studimet post diplomike për zhvillim të fëmijës në Universitetin Shtetëror - Middle Tennessee. Në muajin gusht 2005, Dërvishi publikoi përkthimin në gjuhën shqipe të veprës monumentale të Leo Buscaglias "Rënia e Gje-thit Ilir", që ka të bëjë me jetën dhe vdekjen. Ajo u varros më 17 janar në vendlindje në fshatin Gradicë të Drenicës, ku më shumë se 100 përfaqësues të shoqërisë civile, aktivistë, artistë, politikanë dhe qytetarë u mblodhën për ti bërë nderime.

Safete Rogova, aktiviste nga Motrat Qiriaz pasqyroj jetën e saj gjatë ceremonisë mortore. "Feridja ishte sikurse dielli, duke përhapur ngrohtësi tek të tjerët", deklaroi ajo.

(Vazhdon nga faqja 1)

Përfaqësuesja e Partisë Reformatore ORA dhe Kryesuesja e Komitetit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Social, Fatmire Kollçaku, diskutoi për pesë rekomandimet e përpiluara si rezultat i punës së komitetit në bashkëpunim me Sindikatën e Pensionistëve.

Fatmir Fehmiu nga Sindikata e Pavarur e Pensionistëve ngriti çështjen e nevojës për një shoqëri civile më aktive, posaçërisht të sektorit të OJQ-ve, për të bërë presion ndaj vendimmarrësve që të jenë të vëmendshëm për nevojat dhe të

drejtat e pensionistëve.

Pjesëmarrësit sugjeruan vazhdimin e përpjekjeve për të formuar koalicion të OJQ-ve, i cili do të avokonte në emër të pensionistëve. Ata besojnë se sistemi pensionist është dështim total dhe pozita e pensionistëve në shoqëri duhet të përmirësohet në masë të madhe.

ATRC-ja dhe KODI do të vazhdojnë t'u ndihmojnë pensionistëve për të avokuar për reformim të sistemit pensionist në Kosovë.

Ky ishte diskutimi i parë pu-



Të pranishmit diskutojnë sistemin pensional në Kosovë

blik në kuadër të një serie të debateve të ATRC-së dhe KODI-it për çështje të mbrojtjes sociale dhe po ashtu rasti i parë për të debatuar çështjet pensionist nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm.

Hulumtimi 'Zëri i Popujve' i Index Kosovës dhe Gallup International

Kosova në mesin e vendeve më optimiste në botë, përsëri

Pothuajse gjysma e qytetarëve, të cilët janë intervistuar në kuadër të Hulumtimit 'Zëri i Popujve' i Gallup International në 62 vende anembanë botës, mendojnë se viti 2006 do të jetë vit më i mirë se sa 2005. Hulumtimi u zhvillua në nëntor dhe dhjetor dhe pyetja kryesore ishte "Sa u përket juve, a mendoni se viti 2006 do të jetë më i mirë apo më i keq se 2005?"

Hulumtimi në Kosovë është zhvilluar në nëntor nga Index Kosova me 1.020 qytetarë të moshës 15+ vjeçare, përfaqësues të shqiptarëve të Kosovës dhe minoriteteve, me përjashtim të serbëve.

Optimistët dhe pesimistët

Me gjithë gripin e shpezëve, Vietnami është vendi më opti-

mist në botë, së bashku me Pekinin, Kinë. Kosova e administruar nga OKB-ja radhitet vendi i tretë më optimist në botë.

Këto rezultate janë shumë konsistente - Vietnami ka qenë në krye të vendeve më optimiste për së paku 13 vjet. Ngjashëm, Kosova ka qenë në mesin e vendeve më optimiste gjatë pesë vjetëve të fundit, gjë që sugjeron se misioni paqeruajtës ka sjell stabilitet bashkë me optimizëm të vazhdueshëm për të ardhmen.

Perspektivat ekonomike

Sa i përket Kosovës dhe fqinjëve të saj, optimizmi i qytetarëve kosovar ndaj prosperitetit ekonomik është mjaft i lartë (54%), krahasuar me Maqedoninë (34%), Shqipërinë (33%). Serbia është njëra ndër

vendet më pesimiste në botë ndaj perspektivës ekonomike me vetëm 8% të qytetarëve të intervistuar kanë mendim pozitiv.

Në Kosovë, 36% e qytetarëve besojnë se papunësia do të shtohet vitin e ardhshëm, derisa në vendet fqinje kjo përqindje është më e lartë. Kosova po ashtu është optimiste në çështjen e uljes së shqetësimeve industriale - 36% e të intervistuarve mendojnë se grevat dhe jo stabiliteti industrial do të zvogëlohen në vitin 2006.

Vit i qetë apo me konflikte?

Në fund, respondentët u pyetën për perspektivat lidhur me paqen ndërkombëtare - nëse ata mendojnë se viti 2006 do të jetë paqësor ose me më pak trazira ndërkombëtare, vit me konflikte e me mjaft mosmarrëveshje ndërkombëtare apo do të mbesi i njëjtë.

Në Kosovë, vetëm 19% e respondentëve besojnë se viti 2006 do të jetë vit problematik. Autorizimi për të ri shtypur këtë tekst është marrë nga Index Kosova. Për më shumë informata, ju lutem vizitoni <http://www.indexkosova.com>.

Top Optimists	
2006 will be better than 2005	
Vietnam/Beijing	75%
UN Kosovo	73%
Afghanistan	69%
India/Venezuela/Nigeria	61%
Senegal/South Africa	60%
New Zealand	59%
Canada/Equatorial Guinea	57%
Hong Kong	56%

Një vizion evropian i përbashkët

Lëvizja e lirë e mallrave dhe njerëzve në Kosovë dhe Serbi

Kontribuar nga KIPRED

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) publikoi një raport më 19 dhjetor që gërsheton për herë të parë të dhëna krahasuese në tregti dhe lëvizje. Raporti thekson një numër të qartë të lërmive për autoritetet në rajon dhe komunitetin ndërkombëtar.

Në kohën kur Bashkësia Evropiane përqendron përpjekjet e saja në reformimin e katër lirive të tregut të saj të vetëm, në anën tjetër fqinjët e saj në juglindje përjetojnë një realitet ditor të kufizimeve të mëtuqshme të lëvizjes, edhe pse regjioni është duke u afruar proceseve të integritimit në Bashkësinë Evropiane. Këto kufizime janë prodhim i viteve të tëra me politika të paqarta ndërmjet dhe përgjatë Beogradit dhe Prishtinës dhe kanë rezultuar në një Ballkan të gëtozuar përbrenda Ballkanit perëndimor.

Liria e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve të Serbisë dhe Kosovës nuk është e harmonizuar, transparente apo e qëndrueshme nën rregullimin aktual. Pa marrë parasysh rezultatet e bisedimeve për status të Kosovës, një qasje më e qartë dhe e koordinuar në lirinë e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve të Serbisë dhe Kosovës nga administratat përkatëse në Prishtinë dhe në Beograd dhe prej BE-së është urgjentisht e nevojshme në mënyrë që të sigurohet që mendimet ekonomike dhe sociale të përkrahin më shumë sesa që i pengojnë negociatat politike të vazhdueshme.

Ky raport është zhvilluar nga dy institute hulumtuese, KIPRED në Prishtinë dhe Lëvizja Evropiane në Beograd, Serbi (EMinS).

Tekstin e plotë mund ta lexoni në <http://www.kipred.net/UserFiles/File/Free%20movement%20for%20goods%20and%20people.pdf>

Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni: info@kipred.net



Dhuna ndaj gazetarëve në ngritje

ATRC, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Asociacioni i Gazetarëve Profesionalist të Kosovës (AGPK) kanë organizuar më 13 janar në ATRC diskutim publik për të shqyrtuar incidentet e shtuara, përfshirë dhunën ndaj gazetarëve në Kosovë.

Reagimi i policisë në raste të tilla, kushtet e punës së gazetarëve dhe presioni institucional ndaj mediave të pavarura ishin në fokus të debatit, në të cilin morën pjesë përfaqësues të mediave, OJQ-ve dhe policisë. Jeta Xharra, drejtoreshë e BIRN në Kosovë, moderoi këtë diskutim.

Panelistë ishin Fatos Bytyçi - Kryetar i AGPK-së, Sabit Rrustemi - Zëdhënës i Asamblesë Komunale të Gjilanit, Fatmire Tërdevci - gazetare e Kohës Ditore, Refki Morina - Zëdhënës i Shërbimit Policor

të Kosovës, Afrim Ahmeti - Komandant i Policisë Rajonale të Prishtinës dhe Petrit Selimi - drejtor i gazetës Express.

Panelistët identifikuan tri lloje të presioneve, me të cilat



gazetarët ballafaqohen gjatë punës së tyre të përditshme: presionin fizik, mungesën e qasjes në informacion dhe presionin financiar.

Material filmik u shfaq për pjesëmarrësit, në të cilin paraqiteshin dy raste të dhunës ndaj gazetarëve. Diskutimi që pasoi u përqendrua në sjelljen e policisë dhe autoriteteve të tjera ndaj gazetarëve, sjelljen e gazetarëve dhe masat dici-

plinore për përgjegjësitë.

“Njëzet raste të dhunës ndaj gazetarëve kanë ndodhur në vitin 2005. Incidentet më të rënda janë shkaktuar nga policia”, ka thënë Bytyçi.

Sipas AGPK-së, dy problemet kryesore të sjelljes së policisë me gazetarë janë mungesa e trajnimeve të policisë se si të duhet të bashkëprojnë me media dhe refuzimet e policëve të SHPK-së për t’u shfaqur në televizion.

Refki Morina, zëdhënës i Shërbimit Policor të Kosovës ka deklaruar se SHPK-ja ka marrë masa disiplinore ndaj policëve të cilët i kanë tejkaluar kompetencat e tyre.

Përfaqësues të SHPK-së u kanë bërë thirrje gazetarëve që të kenë kontakte të vazhdueshme me policinë.

Themelimi i rrjeteve të OJQ-ve

OJQ-të e grave RAE formalizojnë rrjetin e tyre

Niveli i ulët i arsimimit (sipas një hulumtimi 90% është shkalla e analfabetizimit në mesin e vajzave), martesat e hershme, varfëria ekonomike në familjet e tyre dhe standartet sociale, të cilat i dekurajojnë gratë të angazhohen në jetën publikë, ka bërë që gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të kenë pak mundësi të participojnë në vendim marrje.

Gjatë pesë vjetëve të fundit, aktivistet e komunitetit RAE kanë punuar në adresimin e këtyre çështjeve. Në fillim të vitit 2000, këto aktiviste i filluan përpjekjet për themelimin e një rrjeti të grave RAE. Ato dëshironin ta hapnin një qendër në Prishtinë, e cila do të përkrahte komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, e posaçërisht gratë në plotësimin e të drejtave të tyre.

Rrjeti ishte regjistruar dhe filluar së funksionuari, mirëpo në fund të 2000-ës filloi të ballafaqohet me vështirësi. Mungesa e sigurisë bëri të pamundur udhëtimin e anëtareve për të marrë pjesë në takime, dhe rrjeti

vuante financiarisht.

“Liria e kufizuar e lëvizjes ndikoi në takimet dhe bashkëpunimin, mirëpo fatmirësisht një pengesë e tillë nuk ekziston më”, ka thënë Emsale Mergjollari, menaxhere e Qendrës së Grave Rome në Prizren dhe udhëheqëse e re e Rrjetit të Grave RAE.

Më 9 dhjetor, Rrjeti i Grave RAE është ristrukturuar dhe formalizuar, përkrahur nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës dhe fasiluar nga ATRC-ja.

Rrjeti përbëhet nga 12 OJQ të grave RAE, i kryesuar nga një trup e re udhëheqëse në krye me Emsale Mergjollarin. Objektivat e rrjetit përfshijnë integritimin e grave RAE në shoqërinë kosovare dhe ngritjen e përfshirjes së tyre në proceset vendim marrëse. Për të arritur këtë, përfaqësueset të Rrjetit të Grave RAE synojnë të shtojnë bashkëpunimin në mesin e OJQ-të të komuniteteve të tyre dhe ti koordinojnë aktivitetet që bashkërisht ti adresojnë çështjet, të cilat

shqetësojnë komunitetin RAE. Në aspektin strategjik, ato do të fokusohen në arsimim, të drejtat e grave dhe bashkëpunim me OJQ-të e tjera në Kosovë dhe rajon.

Gratë RAE ngrenë zërin për nevojat e tyre para vendim marrësve

Çështjet e ballafaquara nga gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane janë diskutuar në debatin e 16 janarit të titulluar “Sfidat dhe Mundësitë e grave RAE për tu integruar në shoqërinë kosovare”, organizuar nga OJQ-ja lokale “Qeliza” dhe Zyra e Kryeministri për Qeverisje të Mirë.

Pjesëmarrës nga qeveria dhe shoqëria civile theksuan se qeveria dhe sektorët e tjerë duhet të hartojnë politika dhe programe për të krijuar parakushte për përmirësimin e pozitës së gruas RAE në shoqëri. Veç kësaj, pjesëmarrësit kërkuan përkrahje institucionale për arsimimin, mbrojtjen ndaj dhunës dhe mirëqenien sociale për gratë RAE të Kosovës.

atrc**Drejtoreshë Ekzekutive**

RREZE DULI

rreze@advocacy-center.org

**Menaxher i Shërbimit
Trajnimeve dhe
Konsultimeve**

ILIR HOXHA

ilir@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante

MERITA BARILEVA

merita@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante

DONIKA SALIHU

donika@advocacy-center.org

Bashkëpunëtore e Programit

NATYRA ZHJEQI

natyra@advocacy-center.org

**Menaxher i Financave &
Administratës**

GANI ASLLANI

gani@advocacy-center.org

**Menaxher për IT dhe
Databazë**

ARMEND SUSURI

armend@advocacy-center.org

**Menaxhere për
Komunikim**


ARJETA DOROCI

arjeta@advocacy-center.org

**Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Tel/Fax: +381 (0) 38 244 810****Duke i ndihmuar shoqërisë civile të zhvillohet****Drejt krijimit të një ambienti të përshtatshëm juridik për shoqërinë civile**

Edhe pse i ndjekin qëllimet publike, organizatat e shoqërisë civile në parim janë organizata private. Mirëpo, kompetencat e këtyre organizatave për të përbushur funksionet e tyre të posaçme varen në masë të madhe nga ambienti juridik në të cilin funksionojnë dhe kjo po ashtu varet edhe nga veprimet e shtetit. Në fakt, një ndër kontributet më të rëndësishme të qeverisë në zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile është themelimi i një ambienti të tillë që krijon mundësi për këto organizata të funksionojnë. Megjithatë, në shumë pjesë të botës korniza ligjore për aktivitetet e shoqërisë civile është e papërcaktuar ose në rastet më të mira e paqartë; e ngarkuar me kontraktika apo nuk është në hap me nevojat aktuale të shoqërisë civile. Edhe pse disa organizata kanë arritur të zhvillohen me gjithë ambientin e papërshtatshëm juridik, përmirësimi i një ambienti të tillë për shoqërinë civile është duke u shndërruar prioritet në tërë botën. Është shumë e qartë se nuk ka mënyrë të vetme ose të "drejtë" për t'i dizajnuar ligjet dhe rregullat për

shoqërinë civile. Traditat ligjore si dhe traditat e aktiviteteve të shoqërisë civile ndryshojnë nga shteti në shtet. Për këtë arsye ek-



zistojnë variacione në mënyrën se si sistemet ligjore merren me çështje vendimtare që i përkasin aktiviteteve të shoqërisë civile. Përkundër variacioneve të tilla, është e mundur të identifikohen disa parime të përgjithshme, të cilat mund të jenë shumë të dobishme për zhvillimin e ligjit për shoqërinë civile në tërë botën. Qëllimi i kësaj deklarate (tekstin e plotë mund ta lexoni në http://www.icnl.org/journal/vol8iss1/special_1.htm) është artikulli i këtyre parimeve të përgjithshme apo udhëzuesve. Kjo deklaratë është produkt i punës së konferencës vjetore të

gjashtëmbëdhjetë të John Hopkins, të partnerëve ndërkombëtare të filantropisë, e mbajtur në Najrobi, Keni, në korrik 2004. Më shumë se 100 aktivistë të shoqërisë civile, ekspertë nga Afrika Lindore dhe mbi 30 shtete nga e gjithë bota kanë marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj deklarate. Deklarata aktuale paraqet sintezën e punës së tyre. Më specifikisht, pas artikullimit të disa supozimeve fundamentale kjo deklaratë adreson katër çështje që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile: e para është pozita bazike ligjore e organizatave të shoqërisë civile si dhe procedurat e regjistrimit që ndihmojnë për t'i definuar ato; e dyta, lehtësimi në taksa për organizatat e shoqërisë civile dhe për filantropi; e treta, transparenca, demaskimi dhe standartet për përgjegjshmëri të këtyre organizatave dhe e katërta, përfshirja e shoqërisë civile në avokim dhe iniciativa qytetare.

Burimi: Revista Ndërkombëtare për Ligjin Jo-Profitabil.

Zhvillimi i shoqërisë civile në Shqipëri

Shoqëria Civile në Shqipëri është duke u rishfaqur gradualisht si fuqi konstruktive e periudhës post komuniste. Në 10 vjetët e fundit në Shqipëri janë paraqitur shumë persona proaktivë të cilët kanë themeluar organizata jo-qeveritare, puna e të cilëve parimisht është bazuar në marrëdhënie personale, besim të dyanshëm dhe konsensus jo-formal. Entuziazmi i tyre për mundësitë e reja në shoqërinë shqiptare ishte motivim i fortë për veprimet e tyre dhe kjo ishte e përkrahur nga korniza ligjore për OJQ-të. Me gjithë paraqitjen e OJQ-ve si faktor me rëndësi dhe ndikim në jetën e Shqipërisë, OJQ-të prapë se prapë ballafaqohen me pengesa. Mungesa e hapësirës për zyre dhe struktura logjistike; definimi i qartë i misionit dhe detyrave të sta-

fit; mungesa e procedurave të cilat udhëzojnë punëtorët në punët e tyre ditore për të siguruar transparencën dhe të kontrollojnë nëse të gjitha çështjet janë në përputhshmëri me funksionet e tyre. Gjithashtu, OJQ-të kanë nevojë për përkrahje në menaxhimin e tyre të brendshëm, në performimin e vlerësimit të nevojave dhe shkruarjes së projekt propozimeve. OJQ-të dhe grupet e komunitetit kanë nevojë për një forum në të cilën do të kenë mundësi të takohen me qeverinë lokale dhe të trajnohen. Institucionet e shoqërisë civile kanë demonstruar një numër të madh të avantazheve krahasuar me institucionet ekzistuese shtetërore. Ato janë më fleksibile dhe më të adaptueshme ndaj ndryshimeve të shpejta të kushteve; ato janë më kreative



Tirana, kryeqytet i Shqipërisë

dhe në të njëjtën kohë më të suksesshme në përfshirjen e njerëzve në nivelin e komunitetit, pasi që përdorin mënyra përfshirëse. Duke pasur parasysh këto beneficione, është me rëndësi të zhvillohet një lidhje profesionale dhe e strukturuar mes organizatave të shoqërisë civile shqiptare dhe organizatave ndërkombëtare donatorëve.

Burimi: www.fco.gov.uk/Files/kfile/CivilSociet%20DevelopmentinAlbania.doc